



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.05, datë 28.12.2022

PËR
KONFISKIMIN PËR INTERES PUBLIK TË OBJEKTIT:
“OBJEKT SHËRBIMI 2 KATE”, ME VENDNDODHJE NË DHËRMI, BASHKIA
HIMARË, TË NDËRTUAR PA LEJE NDËRTIMI

Në mbështetje të nënndarjes “iii” dhe “iv”, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, me propozim të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Konfiskimin për interes publik të objektit “Objekt shërbimi 2 kate”, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues Z. Arton Vezi dhe Z. Adrian Vezi, të ndërtuar pa leje ndërtimi.
2. Planvendosja e objektit të konfiskuar, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Agjencia e Zhvillimit të Territorit të përcjellë këtë vendim pranë Ministrisë përgjegjëse në varësi të të cilës gjendet autoriteti përgjegjës për administrimin e pasurive të konfiskuara të shtetit.
4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ose autoriteti përfitues i konfiskimit të aplikojë nëpërmjet sistemit e-leje, për miratimin e një Leje Zhvillimi/Ndërtimi të re, si dhe lëshimin e Certifikatës së Përdorimit, me qëllim rregullimin e pasojave të shkaktuara nga situata faktike, e krijuar nga ndërtimi pa leje.
5. Pas miratimit të lejes përkatëse, Bashkia Himarë të lëshojë certifikatën e përdorimit, në përputhje me këtë vendim dhe planvendosjen bashkëlidhur.
6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë regjistrimin e këtij vendimi, së bashku me certifikatën e përdorimit, sipas parashikimeve në VKM-në Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat

dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.

7. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I BRENDSHËM


BLEDAR ÇUÇI



ANËTAR

MINISTËR I FINANCËVE DHE EKONOMISË


DELINA IBRAHIMAJ



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

